

22.09.1998, forcat serbe kanë hyrë në Likoshan/Likošane dhe i detyruan banorët dhe refugjatët që të kalojnë në pyjet e afërta. Me këtë rast, Bajrami, Naim Muslimi, Naim Gashi dhe Fejza u ndanë nga familjet e veta dhe u strehuan në një shpellë në kodrën përmbi fshatin Shtuticë/Štutica. Me ta ishin edhe vëllezërit Hysni dhe Elhami, si dhe Qamili me axhën e tij Behramin. Askush prej tyre nuk ka qenë i armatosur.

Të nesërmen, më **23.09.1998**, rreth mesdita, një grup prej 100 policëve të njësiteve të NJPP-së i zbuluan burrat në shpellë. I nxorën jashtë dhe i bastisën. E kanë ndarë Behramin, ndërkaq Bajramin me burra të tjerë i kthyen në shpellë. Pas pak, nga shpella u dëgjuan krismat. Pastaj, i nxorën të gjithë burrat nga shpella, përveç Qamilit, dhe, së bashku me Behramin, u nisën drejt **Dashecit/Doševac**. Rrugës e sipër, policët i ndanë Naim Gashin dhe vëllezërit Elhamiun dhe Hysniun. Ishte kjo hera e fundit që ata të shiheshin të gjallë. Në hyrje të fshatit, policët e liruan Behramin, ndërkaq me Bajramin, Naimin Muslimiun dhe Fejzën vazhduan drejt *Mëhallës Islami* [Dashec/Doševac]. Duke u kthyer në shtëpi, Behrami i ka gjetur trupat e pajetë të Naimit, Elhamiut dhe Hysniut, ndërkaq në shpellë edhe trupin e djalit të vëllait, Qamilit. Një ditë më vonë banorët e fshatit i kanë gjetur trupat e pajetë të Bajramit, Naimit dhe Fejzës të vendi i quajtur *Kërshi i Dashecit/Doševački krš* në *Mëhallën Islami*. Ishin të çekekutuar me plumba në kokë.

Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur burrat e vet të vrarë në varrezat e Shtuticës/Štutica. Pas përfundimit të luftës, më 30.04.2000, mbetjet e tyre mortore u rivarrosen në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Shtuticë/Štutica.

Burimet: deklarata B.B, FDH-15411; deklarata A.O, FDH-2074; deklarata M.R, FDH-32017; deklarata A.I, FDH-32019; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Arif (Sinan) Makolli

(1957, shqiptar nga Skënderaj/Srbica, i papunë, pesë fëmijë)

Arifi punonte si oficer police para viteve të nëntëdhjeta. Kur forcat serbe e nisën sulmin kundër UÇK-së dhe fshatrave në komunën e Skënderaj/Srbica, më 22.09.1998, Arifi me familje u strehuan në bjeshkën e *Çicavicës/Čičavica*, në pyll përmbi fshatin **Kozhicë/Kožica**. Në atë pyll ishin strehuar disa mijëra refugjatë nga fshatrat përreth. Aty e kaluan natën. Të nesërmen [**23.09.1998**], nga ora 13:00, forcat serbe e filluan bombardimin e rajonit. Një predhë ka eksploduar jo larg Arifit, i cili në ato çaste e mbante ngrykë vajzën Shpresën, 11 vjeçe. Një cifël e predhës e ka qëlluar Arifin në gjoks dhe e ka lënë të vdekur në vend. Me këtë rast, u plagosen Shpresa dhe e ëma e Arifit. Ushtarët serb, që u paraqiten menjëherë në vendngjarje, u urdhëruan refugjatëve që të largoheshin nga pylli. Trupi i Arifit ka mbetur në pyll. Ditën tjetër, miku i familjes Rizahu me banorë të Kozhicës/Kožica e kanë marrë trupin e Arifit dhe e kanë varrosur në varrezat lokale në Kozhicë/Kožica. Pas luftime, në muajin prill të vitit 2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Arifit në varrezat e Polacit/Poljance.

Burimet: deklarata H.A, FDH-16633; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P.01434, FDH-33273; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Hasime (Adem Zeqiri) Shabani

(1.05.1950, shqiptare nga Galica, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, amvise, gjashtë fëmijë)

Ku forcat serbe depërtuan më 21.09.1998 në afërsi të Galicës/Galica, Hasimja me vajzat Resmijen, Xhevrijen dhe Lutfijën, si dhe djalin Nystretin e braktisen fshatin. Me një traktor, i cili gjendej në kolonën e formuar nga banorët e fshatit, ata u nisën drejt Vushtrrisë/Vučitrn. Forcat serbe e ndalen kolonën në Novolan/Nevoljane dhe e urdhëruan që të kthehej mbrapa. Hasimja me fëmijët e saj shkuan dhe e kaluan natën në Krasaliq/Krasalić. Një ditë më vonë, forcat serbe e bombarduan Krasaliqin/Krasalić dhe kjo e bëri Hasimen që më fëmijët e saj të zhvendoseshin sërish. Shkuan në **Kozhicë/Kožica**, ku ishte përqendruar një numër i madh refugjatësh nga fsha-